

PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

VNM e Landfillit të mbetjeve të rrezikshme në territorin e Ish-Uzinës së Sodës Vlorë



Përgatitur nga Grup Autorësh

Prof. Asc.	Sazan	GURI	Eksp. mjedisi (G & G group)
M. Sc.	Marianthi	GURI	(Ekspert gjeo-mjedisi)
M. Sc.	Denisa	BALO	(Ekspert Shendetit Publik)
Bch.	Edona	MASATI	(Eksperte Biologe)

Tiranë, Gusht - 2017

HYRJE

Nga Uzina e Plehrave Azotike Fier në likuidim, me adresë Rruga nacionale Fier-Vlorë, Km 3, Fshati "Drize" Fier, që kërkon të kryejë Raportinin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projektit "Landfilli i mbetjeve të rrezikshme" në teritorrin e ish-Uzines se Sode P.V.C Vlore, Studio "G & G Group", me qendër në Tiranë mori përsipër të kryejë këtë Raport, në mbështetje të një aktiviteti të qëndrueshëm dhe afat gjatë në mjedis, të zonës në të cilën do të zhvillohet për pajisen me leje mjedisi në përputhje me ligjin ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" të parashikuar në kategorinë III.2 të shtojcës së Ligjit Nr. 10 081. Qëllimi i studimit është të japë:

- një analizë reale, nga pikëpamja e ndikimit të Vendgrumbullimit të mbetjeve dhe materialeve të kontaminura me zhive në territorin e ish-Uzinën e Sodës Kaustike, Vlore"" mbi banoret dhe në mjedisin natyror;
- analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore;
- dhënien e masave zbutëse për minimizimin e ndikimeve negative;
- marrjen në konsideratë të vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit, gjatë aktivitetit, planin e menaxhimit dhe monitorimet për zërat përkatëse

Ky raport VNM siguron një vlerësim të ndikimeve bazë potenciale të mjedisit mbi projekt dhe hedh dritë mbi masat që duhen marrë për të parandaluar, minimizuar, zbutur apo kompensuar një ndikim mjedisor të pafavorshëm dhe për të përmirësuar shformimet e mundshme mjedisore si edhe mbi menaxhimin e mjedisit dhe planet monitoruese dhe përcakton kërkesën e raportimit në lidhje me to.

Gjatë hartimit të projektit është patur parasysh programi i reabilitimit të zonës në bazë të legjislacionit dhe uljes së ndikimeve në mjedis gjatë fazës së zhvillimit të projektit dhe në përmirësimin e mjedisit aktual në zonë.

Qëllimi i projektit ka qënë ndërtimi i gropes së sigurt ekologjike (CDF) për asgjësimin përfundimtar të mbetjeve të rrezikshme, me sistemimin në mënyrë kapsule brenda territorit të veprave të dikurshme industriale, për të shmangur ndotjen me funksionimin e vend grososjes me kapacitet total 15,000 m³, duke përmbushur të gjitha kërkesat në bazë të kushteve teknike, mjedisore dhe të direktivave të Bashkimit Evropian lidhur me të gjitha vendet grososjet sipas së cilave pjesa fundore e ndërtimit është tërësisht e sigurtë për rrjedhjen e çfarëdo lloji ndotjeje në tokë dhe në ujërat nëntokësorë.

Objekti i punimeve ka qënë pastrimi i zones së ish Uzinës së PVC-së. Godinat e ndotura janë prishur duke perfshire themelet, te tjerat deri ne nivelin e tokes.

Projekti ka konsistuar në reabilitimin e kësaj zone duke grososur mbetjet e rrezikshme të stabilizuara me metodën e kapsulimit në menyrë të sigurte në strukturen e kapsuluar të grumbullimit (CDF, landfill të mbetjeve të rrezikshme), ku ka ndikuar pozitivisht edhe në përmirësimin mjedisit dhe peisazhit në këtë zonë duke sistemuar sheshet, mbushur kanalet dhe në heqjen e mbetjeve inerte. Është punuar në përmirësimin e shesheve dhe shembjen e godinave të dala jashtë funksionit, si dhe në përmirësimin e rrjetit rrugor brënda zonës së projektit. CDF është ndertuar si nje vendgrumbullim për mbetjet e rrezikshme sipas direktivave të EU. Pas punimeve bonifikuese në formë vendgrososjeje, ajo është mbyllur e

mbuluar me dhe', e mbjellë me bar dhe e rrethuar. E gjithë zona ndodhet direkt pas terminalit të ri të naftes, dhe është brenda zonës së saj të sigurisë duke mos lejuar ndertime të reja industriale në këtë zonë.



Koordinatat e landfillit të mbetjeve të rrezikshme në territorin e ish Uzines së Sodës P.V.C. Vlorë, Gusht 2017

Ky raport vlerësimi me objekt mbylljen e landfillit dhe procedurat e kujdesit pas mbylljes të landfillit të mbetjeve të rrezikshme në zonën e Ish Uzines së Sodës P.V.C. Vlorë në shërbim të menaxhimit të infrastrukturës mjedisore, të mbrojtjes së aksidenteve, të përmirësimit të kushteve të punës, ka realizuar:

- Paraqitjen e gjendjes reale e ndikimit të këtij aktiviteti, mbi mjedisin natyror dhe human;
- analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore;
- Propozimet të masave zbutëse për zvogëlimin e ndikimeve negative;
- Shqyrtimi i alternativave të ndryshme brënda projektit.
- Vlerësimi cilësor me pike të ndikimeve në mjedis të projektit
- planin e menaxhimit lokal dhe monitorimet për zërat përkatëse.
- planin për përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit pas ndikimit të mundshëm në mjedis.

2 . METODOLOGJIA E PËRDORUR

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis është bërë në përputhje me ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" i cili është përafëruar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004, "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi mjedisin".

Metodologjia e hartimit të VNM është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës mjedisor e cila është përcaktuar me vendimin Nr. 686, datë 29.7.2015. “Për miratimin e rregullave, të përgjegjëseve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”.

Për realizimin e studimit u kryen:

- ❖ Vrojtime në terren në një rajon të gjerë, duke kryer vrojtime pedologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, ekologjike, si edhe të biodiversitetit. Gjatë vrojtimeve në terren, kujdes i’u kushtua situatës për rreziqet e mundshme natyrore rreth zonës në studim. Për realizimin e objektivave të këtij studimi janë marrë:
 - Foto në territorin në studim;
 - Takime me ekspert lokal dhe komunitetin e zonës;
- ❖ Argumentim i bazuar mbi vlerësimin e:
 - Inventarët e të dhënave ekzistuese;
 - Informacionet bazë, në botimet periodike mbi këtë zonë;
 - Pajtueshmëria me kërkesat ligjore si cilësia e ajrit, zhurmat, dridhjet, rrjedhjet ujore dhe të lëngshme, mbetjet e rrezikshme, zonat e ndotura.
 - Studimit paraprak hidrogeologjik;

d. Vlerësimin me metodën e listë-kontrollit, e cila vendos nga njëra anë të gjitha burimet e mundshme të ndikimeve dhe nga ana tjetër bartësit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhësisë së ndikimit. Madhësia e ndikimit është shprehur me sistem prej 5 shkallësh (+) dhe (-).

e. Përcaktimi i mundësive kryesore të zbutjes së ndikimeve dhe argumentimet përkatëse nëse për ndikime të caktuara mund të zbatohen/ndërmerren masa zbutëse. për

3. KËRKESAT E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË MJEDISIT

Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis i Projektit të Landfillit ka përcaktuar planin e menaxhimit specifik mjedisor e planet monitorues dhe identifikimin e të gjitha nevojave të raportuara, si dhe afatet në përputhje me planet përkatëse të menaxhimit të mbetjeve, të referuara në nenet 10 e 12 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve, si dhe me të gjitha kërkesat përkatëse të **VKM Nr. 452, datë 11.7.2012 PËR LENDFILLET E MBETJEVE**. Gjithashtu janë vlerësuar dhe monitoruar Zbatimi i kërkesave teknike dhe operacionale për mbetjet dhe lëndfilllet, të masave dhe procedurave për parandalimin ose pakësimin sa më shumë të efekteve të mundshme negative në mjedis, në veçanti ndotjen e ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore, tokës dhe ajrit.

4. VLERËSIMI I SITUATËS

Projekti i Landfillit është ngritur mbi një infrastrukturë miqësore me mjedisin, dhe janë marrë në konsideratë kërkesat si më poshtë;

- Plani rregullues egzistues (realizimet dhe mosrealizimet, struktura ekzistuese dhe identifikimi i nevojave);
- Pozicionin gjeografik i landëfillit dhe kufinj të tij;
- Relievi i azhurnuar, të dhëna gjeologjike dhe gjeomorfologjike;
- Të dhëna hidro-gjeologjike, të dhëna klimatike dhe hidrologjike;
- Të dhëna mbi komunitetet bimore, shtazore dhe ekosistemet e zonës në studim;
- Burimet territoriale dhe ekonomike;
- Historia, monumentet e kulturës, arkeologjia;
- Popullsia (gjëndja ekzistuese dhe tendecat e ndryshimeve Pronësia mbi trojet, Strehimi, Arsimi);
- Infrastruktura (rrjeti rrugor, ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefoni);
- Të dhëna mbi infrastrukturën sociale;

II. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Ky projekt ka konsistuar në ndertimin e landfillit (CDF) dhe Planin e mbylljes së fushës së mbetjeve industriale të ish Uzines së Sodes P.V.C. Vlorë për të siguruar që:

- Pika e depozitimit të mbylljes është në përputhje me rregullat dhe legjislacionin në fuqi;
- Sistemet e kontrollit të rrjedhjeve dhe kullimit të ujrave sipërfaqësorë të jenë në gatishmëri të plotë gjatë gjithë fazës së kujdesit të pas-mbylljes;
- Rehabilitimin përfundimtar të tokës;
- Kthimi i sipërfaqes së tokës, në terren rekreativ apo biznesi;
- Përmirësimi i parametrave mjedisorë dhe shëndetësorë për gjithë komunitetin e zonës;
- Kompesimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëra në shkallë rrethi;
- Zbatimi i rregullores së sigurimit teknik.
- Ruajtjen e vlerave ekologjike të peizazhit;
- Rritjen e punësimeve në këto zona.
- Përmirësimin e jetesës së komunitetit të zonës.
- Rritjen e mundësisë për të përdorur shërbimet në investime mbi manaxhimin e mirëmbajtjen e tyre.

III. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME

3.1 Ndikimi në mjedis dhe në veprat përreth

Groposja dhe mbyllja e mbetjeve të rrezikshme të Uzines së Sodes P.V.C. Vlorë, ka ndikuar drejtpërdrejt në:

- Ngritjen dhe zhvillimin e shërbimeve të Administrimit të mbetjeve të rrezikshme me standarte ekologjike.
- Trajtimin përfundimtar të mbetjeve të rrezikshme me groposjen përfundimtare me CDF;
- Përmirësimi i peizazhit natyror dhe i përdorimit të tokës i kësaj zone;
- Specializimin e personelit në shërbim të këtij aktiviteti;
- Përmirësimin në aksesin e sheshit të ish- Uzines së Sodes P.V.C. Vlorë;;
- Zbatimin e kërkesave për ndertimin e landfillit të mbetjeve të rrezikshme me cilësi dhe standart evropian, në mënyrë që ai të shërbejë realisht për një aktivitet të qëndrueshëm;
- Zbatimin e rregullores së sigurimit teknik.
- Ruajtjen e vlerave ekologjike të peizazhit;
- Rritjen e punësimeve në këto zona.
- Eliminimin e një nga nëntë zonat e nxehta të vendit, ku njëherësh trualli i saj do të shërbejë edhe si bazë e mëtejshme për qëllime industriale të komunitetit të zonës.
- Rritjen e mundësisë për të përdorur shërbimet në investime mbi manaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

Sipas studimit të deritanishëm, nuk është identifikuar asnjë “ndikim negativ fatal”, por ekzistojnë vetëm ndikime pozitive, të cilat do zhvillojnë kete zone, si dhe do kontrollohen disa masa zbutëse organizative për të shmangur ndonjë ndikim negativ rastesor nga ato të lidhura me aksidentet njerëzore.

Tabelë përmbledhëse e ndikimeve, që do të gjenerohen nga zhvillimi i aktivitetit

Burimi i Ndikimeve	Objekti mbi të cilin bien	Lloji i ndikimit
Groposja e mbetjeve të rrezikshme në Uzinën e Sodës P.V.C. Vlorë	ajër, tokë	+++ ,garantimi i trajtimit të pastër dhe me efikasitet të mbetjeve të rrezikshme me standarte europiane
Eliminimi i një nga zonat e nxehta të ndotjes historike	Zhvillimi i qendrueshëm	+++ ,garantimi i zhvillimit të industrisë në standarte mjedisore
Përdorimi i sipërfaqeve ekzistuese	tokë	++ ,shmanget ndotja në zonën përreth
Rritja e cilësisë së infrastrukturës mjedisore	Ajër, tokë dhe mbulesa e gjelbër	+ + , shmangia e ndotës që shkaktojnë mbetjet e rrezikshme të patrajtuara; + + , shmangia e riskut në shëndetin human që shkaktojnë mbetjet e rrezikshme të patrajtuara;
Mbjellja e barit dhe bimëve dekorative	Peisazh, humane	+++ , rritja e sipërfaqes së gjelbër në mjedis për përmirësimin e cilësisë së ajrit
Rritja e aksesit të zonës (për përdorim-shfrytëzim, rikrijim)	Mjediset humane	+ + + , konsiderohet si mjaft positive.
Mundësi investimesh	humane	+++ , rritja e punësimit në komunitet.
Gjenerimi i mbeturinave	Mjediset urbanë	+ , menaxhimi rigoroz i tyre

Shpjegim :

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- , Ndikim negativ i lartë
- , Ndikim negativ shumë i lartë
- ? , Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- + , Ndikim pozitiv
- + + , Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- + + + , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Ky aktivitet ka një fokusim të gjerë në rritjen e ndikimeve pozitive gjatë zbatimit të këtij projekti

3.2. Ndikimi në zhurma

Oraret e punës kufizohen në përputhje me standartet kombetare. Gjatë fazes pas ndërtimit të CDF Zhurma është brenda normave të lejuara të zonave industriale dhe me intervale të shkurtra kohore.. Zhurma nuk do të jetë shqetësim kryesor në zonat rrethuese të vendit të landfillit. Në vijim paraqiten nivelet maksimale të zhurmës, që pranohet në kantier rikonstruksioni.

- E vazhdueshme 1.000m nga kantieri 45dBA;
- E çastit 1.000m nga kantieri 55dBA;
- Niveli maksimal 1m nga kantieri 65dBA.

Tabela: Vlerësimi i ndikimeve më të rëndësishme në mjediset humane

1.Lloji i ndikimit	2. Faza e përgatitjes së punimeve të gërmimit të gropave	3. Faza e punimeve në rrugët ndihmëse të landfillit	4. Faza e funksionimit të landfillit
Shqetësimet nga zhurmat dhe dridhjet gjatë operacioneve të punës	Të lehta	Relativisht të rëndësishme	aspak
Shqetësimet nga zhurmat, dridhjet dhe pluhurat gjatë transportit të materialeve	Të lehta	Të rëndësishme	aspak
Shqetësimet nga mbeturina personale të punonjësve dhe mbetje inerte	Të lehta	Relativisht të rëndësishme	aspak

3.3. Masat rehabilituese per kujdesin pasmbylljes se landfillit

Masat rehabilituese në planet e rehabilitimit identifikohen në përputhje me karakteristikat e vlerat e habitatit. Ato jepen të detajuara, duke u grupuar në:

- a) punime inxhinierike;
- b) punime biologjike.

Rigjëlberimi i habitatit me bimësi kryhet, duke i dhënë përparësi bimëve autoktone, të përshtatshme me zonën, që kanë ekzistuar, si dhe bimësisë tjetër që është në përputhje me tipin e tokës. Llojet pyjore që përdoren për ripyllëzimin e sipërfaqes rreth dhe në brendësi të linjës rekomandohen, duke pasur parasysh:

- për mbrojtjen e landfillit nga erozioni të përdoren bar, llojet fletore përherë të blerta;
- për veshjen e terreneve të rreshqitshëm përdoren llojet pyjore të cilat kanë sistem rrënjor të fuqishëm, e mbajnë të mbuluar tokën edhe gjatë stinëve me rreshje të bollshme dhe e lidhin mirë atë;
- për terrene me shfaqje të erozionit duhet të përdoren dhe llojet që lidhin mirë terrenin dhe ndihmojnë parandalimin e erozionit;
- për terrene të eroduara, krahas fidanëve, të përdoret edhe mbjellja me farë.

Kriteret për vlerësimin e rehabilitimit të habitatit të dëmtuar përfshijnë:

- a) zona e rehabilituar do rikthehet në një gjendje të qëndrueshme dhe jo ndotëse;
- b) zona do kthehet në gjendje të përshtatshme për përdorimin e mëtejshëm të planifikuar;
- c) zona do mbrohet nga erozioni;
- d) rigjëlberimi do jetë efektiv në të gjithë sipërfaqen e habitatit, duke vlerësuar densitetin e fidanëve, larminë e llojeve dhe mbulesën bimore, siç është parashikuar në planin e miratuar të rehabilitimit.

3.4. Masa të sugjeruara

Zonat e rehabilituara është inspektuar rregullisht për të vlerësuar shëndetin e vegjetacionit dhe kontrolluar për erozion, dëmtim dhe ndotje nga barërat e këqija. Inspektime të përvitshme janë realizuar pas përfundim të operacioneve për të siguruar suksesin në vazhdim të gjelbërimit. Gjelbërimi i zonës do të rrisë sipërfaqen e gjelbërimit në rajon. Kjo ndërmerret si masë zbutëse mjedisore në këtë territor.

Tabelë përmbledhëse e ndikimeve që do të gjenerohen nga Gjelbërimi i zonës përreth

<i>Burimi i Ndikimeve</i>	<i>Objekti mbi ndikimin</i>	<i>Lloji i ndikimit</i>
Mbjellja e bimëve dekorative	Ajër, tokë	+++ , rritja e sipërfaqes së gjelbër në mjedis për përmirësimin e cilësisë së ajrit +++ , rritja e sipërfaqes së gjelbër në mjedis për mbrojtjen e tokave nga erozioni.
Përdorimi i sipërfaqeve të gjelbëruara	human	++ , mbrojtje e nënstacionit nga gjeorrezizet.
Ndryshim i relievit natyror dhe i formës së përdorimit të tokave	Tokë	+ , përmirësimi i peisazhit natyror.
Punësimi i banorëve përreth.	humane	+++ , rritja e punësimit në komunitet.

Shpjegim:

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- , Ndikim negativ i lartë
- , Ndikim negativ shumë i lartë

- ?, Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- +, Ndikim pozitiv
- ++, Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- +++, Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Ky aktivitet ndikon në rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, por gjithashtu ka një efekt të madh pozitiv, pasi rrit sipërfaqet e gjelbëruara dhe mbrojtjen nga erozioni të zonës përreth, si dhe mbron objektin nga kërcënimet e gjeorrezizqeve.

Monitorimi dhe mirëmbajtja – Kujdesi pasmbylljes së landfillit është një proces që mund të shkojë rreth 20 vite për të dhënë një ekosistem të qëndrueshëm dhe vetë qëndrues. Kujdesi i mëpastajshëm është vitalisht i rëndësishëm dhe çdo dështim duhet të riparohet shpejt.

IV. MASAT E SHMANGIES SË DËMEVE NË STRUKTURE

Rreziqet mjedisore të vendgroposjeve të mbetjeve të rrezikshme normalisht konsiderohen të vogla krahasuar me vendgroposjet bashkiake të mbetjeve të ngurta. Nuk ka në rastin tonë materiale që vetëndizen, ndonëse një vendgroposje MSW është e mbushur plotë me to.

- Nuk ka proces të bio-degradimit, për pasojë nuk ka gaze metan;
- Risku i aromës është pothuajse e papërfillshëm krahasuar me vendgroposjet e mbetjeve bashkiake -MB;
- Sipërfaqja është e vogël krahasuar me vendgroposjet e MB, prandaj sasia e drenazhimit të ujit është shumë e vogël.

Rreziqet e mundshme janë të gjitha veçanërisht të mënjanueshme, në qoftë se është e drejtuar dhe ndërtuar në përputhje me direktivat EU të vendgroposjeve.



Masat e shmangies së ndotjes së ujrave sipërfaqësore

Eksperiencia e deritanishme ka treguar se landfili i mbetjeve të rrezikshme të Uzinës së Sodës P.V.C. Vlorë nuk ka konstatuar shqetësim për ndotjen e ujrave sipërfaqësore, emetime në ajer përreth zonës.

Ujrat e përdorura për sperkatjen e ambienteve grumbullohen dhe derdhen në kanalizimet e ujrave të bardha në kanalin magjstral.

Plani i pjesëmarrjes për konsultimin publik dhe prezantimi i planit

Operatori do drejtojë veprimtarinë e pjesëmarrjes publike në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi. Ai do përgatisë një listë të urdhëresave të qeverisë lokale, të cilat do informohen mbi planet e ecurisë dhe konkluzionet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe institucionin qëndror (Ministrinë e Mjedisit). Ai do organizojë edhe një mbledhje me pjesëmarrjen publike të ambientalistëve rajonalë dhe të njerëzve që janë të ndjeshëm ndaj problemeve të mjedisit. Stafi i tij duhet të ndërgjegjësojë opinionin publik mbi llojin e projektit, kohëzgjatjen e tij, masat që ka planifikuar të marrë për zbutjen e ndikimeve negative të mundshme, shpërblimin në rast dëmtimesh të pronarëve, mundësinë e punësimit vendor, pra, gjithçka që do të bëhet, do ketë për bazë respektimin në maksimumin e mundshëm të mjedisit.

Vlerësimi i Alternativës parë "pa projekt"

Kjo alternativë mbetet në konsideratë, duke patur parasysh përshkrimin e mjedisit të dhënë më sipër. Zona e vendgroposjes me CDF dhe Plani i mbylljes së fushës së mbetjeve të rrezikshme të Uzines së Sodës P.V.C. Vlorë, përbën një territor industrial, ku kërkesa e sigurisë se mjedisit është shumë e lartë dhe do të mbetet e tillë edhe për vitet në vazhdim. Mundësia e mos ndertimit të landfillit për pasojë mos trajtim të mbetjeve të rrezikshme të zonës në studim, është kercenim për komunitetin dhe mjedisin e zones nga mbetjet e rrezikshme të kësaj fabrike të pa trajtuara. Duke përmbledhur sa u tha më sipër u vlerësua që alternativa e "jo-ndertimit të landfillit" do të përfshijë më shumë impakte negative në zone sesa do të shkaktojë operimi i këtij aktiviteti.

Ndikimet kryesore në mjedis në Alternativën e mos ndertimit të landfillit

Objekti mbi të cilin bien	Lloji i ndikimit
Mos trajtim i mbetjeve të rrezikshme	---, mos zbatimin e detyrimeve ligjore të administrimit të mbetjeve të rrezikshme; ---, Gjenerimi dhe shtimi i mbeturinave të rrezikshme
Problemet shendetesore	---, shtimi i kërcënimit të numurit të njerëzve të sëmurë;
Mjedisi lokal	---, Ndotje mjedisore lokale (Ujra, ajer dhe toka);
Degradimi i ambientit	---, mos menaxhimi i territorit;
Probleme imazhi	---, rëndohet pamja e zonës industriale dhe perreth
Problemet sociale	---, shtohen dhe perkeqesohen problemet sociale të zonës

Alternativën specifike të funksionimit të projektit, ku përfshihen:

- Pozicionimi i elementeve kyçe të projektit;
- Alternativat për pozicionimin e sistemeve dhe veprimeve ndihmëse për punimet;
- Zhvillimi i projektimit të metodave optimale të ndertimit të landfillit;
- Metodatat dhe teknologjitë e funksionimit të këtij projekti.

Alternativa II – Ndertimi i landfillit në zonën në studim

Ky është aktiviteti kryesor, që mendohet se ka ndikimet më të mëdha pozitive, jo vetëm nga pikëpamja e efekteve momentale, por edhe për jetë gjatësinë e tyre. Ndertimi i landfillit, do të ketë jo vetëm efekte të drejtpërdrejta dhe momentale, por koha e gjatë e qëndrueshmërisë së tyre do të ndikojnë pozitivisht pas përfundimit të punimeve të projektit.

V. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR

Objekti në studim nuk do të ketë ndikime në mjedisin ndërkufitar pasi ndodhet në Bashkinë e Vlorës dhe është landfill i groposjes së mbetjeve të rrezikshme që menaxhon brenda territorit të tij dhe nuk ka ndikime mjedisore reziduale që mund të përhapen në distanca të mëdha që të rrezikojnë vendet fqinje.

Mjedisi ndërkufitar nuk përfshihet në teritorrin e këtij projekti ndaj nuk do të ketë.

VI. LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE E RREZIKSHME

Bazuar në LIGJI Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”, Ku specifikohet në Neni 53 Kërkesa për leje mjedisi, Personat fizikë a juridikë, që synojnë të kryejnë operacione për trajtimin e mbetjeve, pajisen me leje mjedisi në përputhje me ligjin ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, si dhe në VENDIM Nr. 452, datë 11.7.2012 **PËR LENDFILLET E MBETJEVE**_funksionojnë kërkesat teknike dhe operacionale për mbetjet dhe lëndfillet. Vleresimi ynë është fokusuar në përputhje me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, leja e mjedisit e tipit A ose B për një vend lëndfilli i cili duhet të përfshijë, informacionin dhe kërkesat që vijojnë për:

- a) kategorinë e lëndfillit;
- b) listën e llojeve të përcaktuara të mbetjeve që lejohen të depozitohen në lëndfill;
- c) sasinë totale të mbetjeve që lejohet të depozitohet në lëndfill;
- d) kërkesat për operacionet e asgjësimit në lëndfill dhe procedurat e vetëmonitorimit e të kontrollit të lëndfillit;
- e) kërkesat kushtëzuese për operacionet e mbylljes dhe të kujdesit pas mbylljes;
- dh) detyrimin e operatorit për të raportuar, një herë në vit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për llojet dhe sasinë e mbetjeve të asgjësuar dhe për rezultatet e programit të vetëmonitorimit.

Sipas LIGJI Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”, Neni 43, Lëndfillet klasifikohen në tri kategori:

- a) lëndfille për mbetjet e rrezikshme;
- b) lëndfille për mbetjet jo të rrezikshme;
- c) lëndfille për mbetjet inerte.

2. Mbjetet çohen në lëndfill vetëm nëse i janë nënshtruar trajtimit.

3. Lëndfillet e mbetjeve të rrezikshme përdoren për ato mbetje të rrezikshme që plotësojnë kriteret e pranimit në lëndfillet e mbetjeve të rrezikshme.

Neni 45, Operacionet e lëndfilleve, Këshilli i Ministrave, miraton kërkesat për operacionet që kryhen në lëndfille, përfshirë:

- a) procedurat e pranimit të mbetjeve;
- b) procedurat e kontrollit e të monitorimit;

c) procedurat e mbylljes dhe të kujdesit të mëtejshëm;

6.2. Informacion për autorizimet

Legjislacioni kryesor Shqiptar për mjedisin

Shtylla kurrizore për raportet e VNM në fushën legjislativë është *Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 për "Mbi mbrojtjen e mjedisit"*. Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, mbi bazën e parimeve, kërkesave, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit.

Ligji Nr. Nr. 10 431, datë 9.6.2011 për "Mbi mbrojtjen e mjedisit"

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, mbi bazën e parimeve, kërkesave, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit.

LIGJ Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 "PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS"

Ky ligj synon të sigurojë:

- a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- b) garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara së organeve qendrore dhe vendore, antarëve të publikut, organizatave jofitimprurëse, nëpërmjet një vlerësimi të integruar dhe kohor të impaktit në mjedis të projekteve dhe veprimtarive.

neni 7 Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis

1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.

3. Dokumenti bazë, ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Neni 10 Paraqitja e kërkesës për vlerësimin e ndikimit në mjedis nga zhvilluesi

Zhvilluesi, për projektet me ndikim në mjedis, që janë subjekt i këtij ligji, paraqet pranë MM-së, përveç dokumentacionit të kërkuar edhe dokumentacionin përkatës për procedurën e VNM-së, përfshirë për projektet e shtojcës II:

- i) projektin teknik të veprimtarisë;
- ii) raportin e ndikimit në mjedis të VNM-së, të hartuar sipas llojit të projektit;
- iii) faturën e pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve të nenit 27 të këtij ligji.

Neni 16 Informimi i publikut gjatë VNM-së

1. Zhvilluesi, për projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të VNM-së, informon dhe konsultohet me publikun për vlerësimin e ndikimit në mjedis të veprimtarisë së tij.

2. Informacionin për informimin dhe konsultimin me publikun, zhvilluesi e paraqet si pjesë të dokumentacionit të nevojshëm gjatë aplikimit për deklaratën në QKL.

VENDIM Nr. 686, datë 29.7.2015 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË AFATEVE PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)

DHE PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË VENDIMIT E DEKLARATËS MJEDISORE

KREU I, zhvillimi i procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis

1. Zhvilluesi që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i kërkesave të nenit 8, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, që në fazat fillestare të planifikimit të projektit (projektidesë), paraqet pranë Ministrisë së Mjedisit kërkesën me shkrim dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

1.1 Raportin teknik të projektit të propozuar, I cili përfshin:

- a) qëllimin e projektit të propozuar;
- b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
- c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;
- ç) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;
- d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- dh) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
- e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
- f) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
- g) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- gj) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
- h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
- i) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/ autorizimin/ licencimin e projektit;

1.2 Raportin paraprak të VNM-së, ku përfshihen:

- a) përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
- b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;
- c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
- ç) një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;
- d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;
- dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton

- distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
- e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
 - ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
 - f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Raporti i paraprak i VNM-së të jetë i nënshkruar nga personi fizik/juridik i licencuar.

1.3 Aktin e regjistrimit të personit fizik/juridik, sipas legjislacionit në fuqi.

1.4 Një kopje të faturës së pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

2. Dokumentacioni i kërkuar në pikën 1, dorëzohet edhe me CD/DVD, në 10 kopje.

LIGJI Nr.10 448, datë 14.7.2011 "PËR LEJET E MJEDISIT"

Neni 4 Sistemi i lejeve të mjedisit

1. Në përputhje me ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:

b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji;

2. Autoritetet kompetente për lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C janë si më poshtë:

a) Qendra Kombëtare e Licencimeve është autoriteti ku bëhet kërkesa dhe ku lëshohet leja e mjedisit të tipit A, B dhe C;

b) Ministri është autoriteti që firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi ato të shqyrtohen dhe përgatiten nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

c) Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit A dhe B dhe që i jep mendimin e argumentuar ministrit për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga AKM-ja

Kreu III, "lejet e mjedisit të tipit b" neni 20

Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B.

- Instalimet e kategorisë B pajisen me leje mjedisi të tipit B, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

Shqipëria është palë në Konventa që lidhen me mbrojtjen e specieve në përgjithësi, duke përfshirë dhe ato detare. Janë Konventa e Bernës për florën dhe faunën e egër të Evropës, Konventa Ramsar për ligatinat e rëndësisë ndërkombëtare, të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër. Gjithashtu, ky projekt nuk bie kundër edhe me nenet, që mbështeten në ligjin e Pyjeve dhe Gjuetisë dhe udhëzimet e tij, as me ligjin për përdorimin e fondit pyjor-kullosor. Pas marrjes së lejes së ARM-së, materiali së bashku me dokumentacionin do të dërgohet pranë Ministrisë përkatëse, ku do të merret leja e Mjedisit. Realizimi i detyrimeve, që dalin nga ky projekt mbetet objekt kryesor i punës, së subjektit investues.